

MIRATOHET
DREJTORIA E RAJONIT QENDER PERENDIM
TIRANE

DREJTORI
ERION KOKA

RELACION TEKNIK
(PROJEKT ME PERSHKRIM)

Mirëmbajtje me performancë “Tiranë - Linzë- Qafë Priskë, Qafë Priskë -Qafë Mollë, Trau Dajt - Kamp, Kryq. Dajt - Vila Qeveritare, Rot. TEG – Ibë, Ura e Farkës - Baldushk - Mustafa Koçaj, Vaqarr - Arbanë –Vishaj”, (64.1 km) (Kontrata 3)

- **Qëllimi i Shërbimeve që do kryhen**

Shërbimet që do mundësohen përfshijnë gjithë veprimtaritë, fizike dhe të tjera, që duhet të kryhen, sipas përputhshmërisë së tyre me Nivelet e Shërbimit dhe kriterin e caktuar të realizimit të tyre të performancës, sipas Specifikimeve Teknike.

- **Segmentet që mbulon kontrata**

Nr. Rrugës	Indeks	Emërtimi i Rrugëve	Tipi rrugës	Gjatësia totale (km)
		MIRËMBAJTJE RUTINE		
54	3/3	Tiranë (Linzë - Qafë Priskë)	SMTW	14.3
54	3/4	Qafë Priskë - Qafë Mollë (pa asfalt)	SMTWM	7
47	3/1	Trau Dajt - Kamp	SMTW	8
47	3/2	Kryq. Daj – Vila Qeveritare	SMTWM	0.6
3	4/2	Rot Teg - Ibë	SMTM	10.8
ska	4/9	Ura e Farkës - Baldushk - Mustafa Koçaj	SFL	14.5
ska	4/10	Vaqarr - Vishaj (k/Baldushk)	SFL	8.9
	1	GJATËSIA KM KONTRATA 3		64.1

Shënim:; SMTW – rrugë në terren malor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore, SMT – rrugë në terren malor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore, SMTWM – rrugë në terren malor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore me risk mesatar.

- **Kusht i veçantë**

Për çdo rast, nga kontrata do të zbriten segmente të saj nqs do të përfshihen në investim (rikonstruksion) apo projekte të tjera të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

- **Sinjalistika dhe siguria rrugore**

Mirëmbajtja e sinjalistikës dhe siguria rrugore (barrierat) do të fokusohet tek riparimi dhe rifreskimi e asaj ekzistuese.

- **Përshkrimi i zonës ku ndodhet rruga**

Tiranë (Linzë) - Qafë Priskë

Pershkrimi i Rruges :Ky segment rrugor është në pjesën verilindore të Qytetit të Tiranës . Është segment me një karrexhatë me gjerësi që varion nga 3m, 3.5m dhe 4m duke ofruar dy kahë lëvizje . Kjo rrugë është relativisht e gjerë për një rrugë qyteti standarte. Rëndësia e këtij aksi është e madhe pasi lidh zona të ndryshme periferike të Tiranës.

Shtresat asfaltike: Shtresat asfaltike në pjesën e fillimit dhe mbarimit janë në kushte të mira dhe të mirëmbajtura në standartet e duhura teknike .

Gjendja e Kanaleve Anësore dhe Tombinot: Kanalet anësore dhe tombinot janë në gjendje të mirë, kjo tregon që rruga është në përgjithësi funksionale për t'i lejuar drenazhin e ujit nga terreni.


Sinjalistika Vertikale :Në gjithë gjatësinë e rrugës ka tabela të cilat përcaktojnë kufirin e shpejtesisë dhe kryqezimet apo kthesat , rrethrotullimet apo vendet ku ka kalim këmbësorësh por ka nevojë për një numër më të madh të tyre duke vlerësuar rëndësinë që ka ky aks . Në pjesën më të madhe të gjatësisë së rrugës vijëzimi horizontal nuk e lejon parakalimin por duhet shoqëruar edhe me sinjalistike vertikale .

Sinjalistika Horizontale :Sinjalistika horizontale në këtë segment është e mirë por ka nevojë për rifreskim me punime rutinë.

Nevoja për Rifreskim të Sinjalistikës dhe Sigurisë Rrugore: Në përgjithësi në gjatësinë e këtij segmenti sinjalistika vertikale dhe horizontale është e evidentë ose e zbehur në vende të caktuara .

Rruga është në terren kodrinor - malor dhe me mirëmbajtje dimërore.

Niveli i kërkuar i shërbimit “I mirë”.



Qafë Priskë - Qafë Mollë

Ky segment rrugor është degëzim në anën e majtë të rrugës nr. 54, Qafë Priskë- Qafë Mollë në zonë rurale. Është segment me një karrexhatë, me gjerësi 4 dhe 3.5m.


Shtresat asfaltike në pjesën e fillimit janë të dëmtuara.

Kanalet anësore dhe tombinot janë në gjendje funksionale por kanë nevojë për pastrim.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme si dhe shtim të sinjalistikës vertikale

Rruga është në terren malor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore me risk mesatar.

Niveli i kërkuar i shërbimit “mjaftueshëm”. Segmenti ka nevojë për rikonstruksion (investim) nga ARrSh.



Trau Dajt – Kamp

Trau Dajt - St. Teleferikut është një rrugë me gjatësi prej 8 km , ndodhet si degëzim në anën e majtë të rrugës nr. 47, brenda zonës së mbrojtur të Parkut Kombëtar të Dajtit. Ky segment ka një karrexhatë me dy kahe lëvizje, duke u shërbyer trafikut në të dy drejtimet.

Rruga është e asfaltuar me karrexhatë me gjerësi 3 deri në 3.5 m e cila kalon në terren malor derisa ngjitet te rruga e teleferikut.

Siguria Rrugore - Në disa segmente ka ende nevojë për mbrojtëse metalike si dhe tabela .

Shtresat e Rrugës - Shtresat asfaltike janë në gjendje jo të mira në disa segmente të kësaj rruge për shembull nga km 0+000 në km 1+700 si dhe nga nga km 6+400 në km 7+800 prej gati 10,850 m² rruga është shumë e dëmtuar me gropa të mëdha e plasaritje, kjo si pasojë dhe e problematikave gjatë periudhës së dimrit ku reshjet e dendura të dëbores, ulja e temperaturave , shkarjet e dherave dhe rënia e gurëve i prishin keto shtresa asfaltike.

Niveli i kërkuar i shërbimit “mjaftueshëm”. Segmenti ka nevojë për rikonstruksion (investim) nga ARrSh.



Deg. Dj. maja e Dajtit - Vila Qeveritare

Ky segment rrugor është degëzim në anën e djathtë të rrugës nr. 47, Trau Dajt – Deg. dj. Vila Qeveritare në zonen e mbrojtur të Parkut Kombëtar të Dajtit. Rruga është një karrexhatë e vetme me një gjerësi që varion 3.5 m me dy sense levizje .

Shtresat asfaltike në këtë segment janë në gjendje pjesërisht të mirë.

Kanalet anësore dhe tombinot janë në gjendje të mirë .

Ky segment rrugor ka nevojë për Sinjalistikë horizontale/vertikale.

Rruga kalon në terren malor derisa ngjitet te Vilat Qeveritare . Kjo është një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore me risk mesatar.

Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.



Rot Teg – Ibë

Ky segment rrugor është pjesë e rrugës së vjetër nr. 3.


Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Shtresat asfaltike janë në kushte të mira. Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për pastrim të pjesshëm.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme.

Rruga është në terren malor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore me risk mesatar.

Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.



Ura e Farkës - Baldushk - Mustafa Koçaj

Ky segment rrugor është degëzim djathtas i rrugës nr.3, Tiranë – Elbasan.


Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Shtresat asfaltike janë në kushte të mira me nevoja për riparime. Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për pastrim të pjesshëm.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme.

Rruga është në terren fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.

Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.



Ura e Farkës - Baldushk - Mustafa Koçaj

Vaqarr – Arbanë – Vishaj

Ky segment rrugor është degëzim majtas i rrugës nr.56, Tiranë – Durrës.


Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Shtresat asfaltike janë në kushte të mira me nevoja të pakta për riparime. Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për pastrim të pjesshëm.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme.

Rruga është në terren fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.

Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.



Përgatitën

Rajmonda Levanaj

Brunilda Kodra

Xhevdet Mulaj

Donika Mihali

Xhuljana Shehu

Ismail Ruçi

Mondi Sako

